



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
NJËSIA E PROKURIMEVE

Nr. 19450 Prot

Shkodër, më 28.12 .2022

KONTRATË SHËRBIMI NR.3  
REF-91462-03-29-2021

**"Shërbimi i internetit ne Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qendrat Komunitare"**

E lidhur sot me datë 28.12.2022, midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z.Bardh Spahia** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.

*Dhe Operatorit ekonomik "ITCOM" sh.p.k* regjistruar me regjistrim fillestar me nr. CN-185667-10-08 me seli te shoqerise: Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeg, pall 164 shk 1, me nr.pasurie 4/337+1-1/2, zona kadastrale 8597-Shkoder perfaqësuar nga administratori ligjor z.Marin Palushi, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **"Kontraktuesi"**

**Neni 1**

**Baza ligjore**

- Kodi Civil ligji miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, të ndryshuar
- Ligji Nr. 162, dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", nenin 52 të ligjit.
- VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 59, nenit 60, pika 1/a) e nenit 64, nenit 65 të kreu VI.
- Ligji nr.48/2014 "Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore e tregtare" i ndryshuar.
- Udhëzimi nr.30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik"
- Marreveshjes kuader nr.1926/25 prot date 01.06.2018

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al) e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Konceptoi E Dizuari



## Neni 2

### Objekti i kontratës

- 2.1 Objekt i kësaj kontrate është shërbimi me objekt: **"Shërbimi i internetit ne Bashkinë Qendër, 10 Njësitë Administrative, 5 Lagjet, dhe në Qendrat Komunitare"** në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhena në dokumentat e tenderit dhe që **Kontraktuesi – "ITCOM" sh.p.k** pranon t'i realizojë sipas ofertës së ofruar dhe pranuar si fituese në procedurën e prokurimit.

## Neni 3

### Vleftha e kontratës

- 3.1. Kontraktuesi merr përsiper të kryeje të gjitha shërbimet tek Autoriteti Kontraktor sipas objektit të lartpërmendur në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të dhena në dokumentat e tenderit, kundrejt një vlere totale prej **1,312,800** (Njemilion e treqind e dymbëdhjetemije e teteqind) lekë pa tvsh dhe **1,575,360**(Njemilion e pesëqind e shtatedhete e pesemije e treqind e gjashtedhete) lekë me tvsh.
- 3.2. Financimi realizohet nga Buxheti i Bashkisë Shkoder
- 3.3. Çmimet e kontraktorit për shërbimet e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

## Neni 4

### Afati i kontratës

- 4.1 Kontrata do të realizohet nga data **01.01.2023** deri me **31.12.2023**.

## Neni 5

### Gjuha e kontratës

- 5.1 Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

## Neni 6

### Qëllimi

- 6.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 6.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 6.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 6.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjane kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

- 6.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

## Neni 7

### Përkufizime

- 7.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 7.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- 7.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 7.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 7.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të përkufizuar në ligj.
- 7.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 7.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 7.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

## Neni 8

### Hartimi i Kontratës

- 8.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 8.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

## Neni 9

### Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 9.1 Autoriteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 15 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

- 9.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 9.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

## Neni 10

### Informacioni Konfidencial

- 10.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 10.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 10.1 më sipër.

## Neni 11

### Prona Intelektuale

- 11.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 11.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 11.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## Neni 12

### Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkoder, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Page 4 of 27

Konceptori E Dizdari



- 12.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 12.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 12.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 12.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

### Neni 13


#### Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit


- 13.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 13.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 13.3 *Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet mujore të lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë duke evidentuar të gjitha problematikat e hasura gjatë ofrimit të shërbimit të internetit.*

#### Infrastruktura e rrjetit dhe ndërlidhja

Shërbimi i Internetit do të jetë një sistem i qendëruar në të cilin përdoruesit e Njësive Administrative, Rajoneve, dhe Qendrave Komunitare do të lidhen tek Server-at qendrorë të aplikimeve dhe të të dhënave të cilët janë të vendosur në Bashkinë Qendër të bashkisë Shkodër.

Arkitektura e nivelit të lartë të komunikimit dhe ofrimit të shërbimit të internetit të Njësive Administrative dhe Bashkisë Qendër duhet të jetë si mëposhtë vijon:






Bashkia Shkodër ka nën administrimin e saj 10 Njësi Administrative (ish-Komuna): Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Gur i Zi, Postribë, Pult, Rrethina, Shosh, Shlaë, Velipojë si dhe 5 Rajone, Qendra Komunitare e Zyra Informacioni Njesive Administrative, Rajoneve, Qendrave Komunitare dhe Zyrave te Informacionit, do t`ju referohemi me poshtë me termin "Njësi".

Siç vihet re nga skema e mësipërme, në Njësinë Administrative Velipojë do të jetë i vendosur Secondary Production Server i cili përmes komunikimit në internet dhe menaxhimit të këtij komunikimi përmes Encrypted VPN Router do të jetë një magazinë rezervë e bazave të të dhënave dhe aplikimeve qendrore të Datacenter-it që ndohet në Bashkinë Qendër. Po ashtu të gjitha Njësitë e tjera do të marrin shërbimin e internetit nga Bashkia Qendër të menaxhueshëm përmes Encrypted VPN Router, siç vihet re edhe në të djathtë të skemës së mësipërme. Secila nga Njësitë do të këtë të vendosur një Encrypted VPN Router, të cilët do të menaxhohen nga Encrypted VPN Router i Bashkisë Qendër, në mënyrë që të mund të vendosen rregullat e shpërndarjes së internetit dhe të komunikimit të të dhënave bazuar në internet në mënyrë të qendërzuar nga Bashkia Qendër drejt Njësive.

Arkitektura e rrjetit të komunikimit duhet të jetë si në figurën e mëposhtme:



## Vendndodhja e Instalimeve

Operatori Ekonomik i ofrimit të shërbimit duhet të sigurojë lidhjen e linjave të komunikimit (setup) sipas kapaciteteve për secilën Njësi dhe për Bashkinë Qendër, si më poshtë vijon:

1. Njësia Administrative Shkodër
  - a. Bashkia Qendër
  - b. Njësia e Prokurimit
  - c. Rajoni Nr. 1
  - d. Rajoni Nr. 2
  - e. Rajoni Nr. 3
  - f. Rajoni Nr. 4
  - g. Rajoni Nr. 5
  - h. Qendra Komunitare Nr. 3
  - i. Qendra Komunitare Nr. 4
  - j. Qendra Komunitare Nr. 5
  - k. Qendra Komunitare Nr. 6
  - l. Qendra Komunitare Multifunksionale
  - m. Qendra Komunitar Rinore "Atelie"
  - n. Qendra komunitare e Autizmit
  - o. Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint)
2. Njësia Administrative Ana e Malit
3. Njësia Administrative Bërdicë
4. Njësia Administrative Dajç
  - a. Njësia Administrative Dajç
  - b. Qendra Komunitare Mushan
5. Njësia Administrative Gur i Zi
  - a. Njësia Administrative Gur i Zi



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Page 7 of 27

Konceptoi E Dizdani



- b. Qendra Komunitare Gur i Zi
- 6. Njësia Administrative Postribë
- 7. Njësia Adminsitrative Pult
- 8. Njësia Adminsitrative Rrethina
  - a. Njësia Adminsitrative Rrethina
  - b. Qendra Komunitare Shtoj
- 9. Njësia Administrative Shalë
  - a. Njësia Administrative Shalë
  - b. Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Theth - Sezonal)
- 10. Njësia Administrative Shosh
- 11. Njësia Administrative Velipojë
  - a. Njësia Administrative Velipojë
  - b. Njësia Administrative Velipojë (Plazh - Sezonal)
  - c. Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint. Plazh - Sezonal)

### Linjat Primare - Bandwidth-i linjave të komunikimit

Linjat primare të komunikimit të ofruara për çdo Njësi dhe për Bashkinë Qendër duhet të kenë kapacitetet si më poshtë vijon:

Nr	Vendndodhja	Bandwidth
1	Bashkia Qendër	10 Gb
2	Njësia e Prokurimit	1 Gb
3	Rajoni Nr. 1	1 Gb
4	Rajoni Nr. 2	1 Gb
5	Rajoni Nr. 3	1 Gb
6	Rajoni Nr. 4	1 Gb
7	Rajoni Nr. 5	1 Gb
8	Qendra Komunitare Nr. 3	1 Gb
9	Qendra Komunitare Nr. 4	1 Gb
10	Qendra Komunitare Nr. 5	1 Gb
11	Qendra Komunitare Nr. 6	1 Gb
12	Qendra Komunitare Multifunkionale	1 Gb
13	Qendra Komunitar Rinore "Atelie"	1 Gb
14	Qendra komunitare e Autizmit	1 Gb
15	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint)	1 Gb
16	Njësia Administrative Ana e Malit	1 Gb
17	Njësia Administrative Bërdicë	1 Gb
18	Njësia Administrative Dajç	1 Gb
19	Qendra Komunitare Mushan	1 Gb
20	Njësia Administrative Gur i Zi	1 Gb
21	Qendra Komunitare Gur i Zi	1 Gb

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkoder. web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al) e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Konceptoi E Dizdani





22	Njësia Administrative Postribë	1 Gb
23	Njësia Adminsitrativë Pult	1 Gb
24	Njësia Adminsitrativë Rrethina	1 Gb
25	Qendra Komunitare Shtoj	1 Gb
26	Njësia Administrative Shalë	1 Gb
27	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Theth - Sezonal)	1 Gb
28	Njësia Administrative Shosh	1 Gb
29	Njësia Administrative Velipojë	1 Gb
30	Njësia Administrative Velipojë (Plazh - Sezonal)	1 Gb
31	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Plazh - Sezonal)	1 Gb

### Linjat Backup - Bandwidth-i linjave të komunikimit

Nr	Vendndodhja	Bandwidth
1	Bashkia Qendër	50 Mb
2	Njësia e Prokurimit	10 Mb
3	Rajoni Nr. 1	10 Mb
4	Rajoni Nr. 2	10 Mb
5	Rajoni Nr. 3	10 Mb
6	Rajoni Nr. 4	10 Mb
7	Rajoni Nr. 5	10 Mb
8	Qendra Komunitare Nr. 3	10 Mb
9	Qendra Komunitare Nr. 4	10 Mb
10	Qendra Komunitare Nr. 5	10 Mb
11	Qendra Komunitare Nr. 6	10 Mb
12	Qendra Komunitare Multifunksionale	10 Mb
13	Qendra Komunitare Rinore "Atelie"	10 Mb
14	Qendra komunitare e Autizmit	10 Mb
15	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint)	10 Mb
16	Njësia Administrative Ana e Malit	10 Mb
17	Njësia Administrative Bërdicë	10 Mb
18	Njësia Administrative Dajç	10 Mb
19	Qendra Komunitare Mushan	10 Mb
20	Njësia Administrative Gur i Zi	10 Mb
21	Qendra Komunitare Gur i Zi	10 Mb
22	Njësia Administrative Postribë	10 Mb
23	Njësia Adminsitrativë Pult	10 Mb
24	Njësia Adminsitrativë Rrethina	10 Mb
25	Qendra Komunitare Shtoj	10 Mb

26	Njësia Administrative Shalë	10 Mb
27	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Theth - Sezonal)	10 Mb
28	Njësia Administrative Shosh	10 Mb
29	Njësia Administrative Velipojë	10 Mb
30	Njësia Administrative Velipojë (Plazh - Sezonal)	10 Mb
31	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Plazh - Sezonal)	10 Mb

### Linjat Primare - Shpejtësia e linjave të komunikimit

Linjat primare (Main) të komunikimit të ofruara për çdo Njësi dhe për Bashkinë Qendër duhet të kenë shpejtësinë si më poshtë vijon:

Nr	Vendndodhja	Shpejtësia (Download / Upload)
1	Bashkia Qendër	1 Gbps / 1Gbps
2	Njësia e Prokurimit	100 Mbps / 100Mbps
3	Rajoni Nr. 1	100 Mbps / 100Mbps
4	Rajoni Nr. 2	100 Mbps / 100Mbps
5	Rajoni Nr. 3	100 Mbps / 100Mbps
6	Rajoni Nr. 4	100 Mbps / 100Mbps
7	Rajoni Nr. 5	100 Mbps / 100Mbps
8	Qendra Komunitare Nr. 3	100 Mbps / 100Mbps
9	Qendra Komunitare Nr. 4	100 Mbps / 100Mbps
10	Qendra Komunitare Nr. 5	100 Mbps / 100Mbps
11	Qendra Komunitare Nr. 6	100 Mbps / 100Mbps
12	Qendra Komunitare Multifunksionale	100 Mbps / 100Mbps
13	Qendra Komunitare Rinore "Atelie"	100 Mbps / 100Mbps
14	Qendra komunitare e Autizmit	100 Mbps / 100Mbps
15	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint)	100 Mbps / 100Mbps
16	Njësia Administrative Ana e Malit	100 Mbps / 100Mbps
17	Njësia Administrative Bërdicë	100 Mbps / 100Mbps
18	Njësia Administrative Dajç	100 Mbps / 100Mbps
19	Qendra Komunitare Mushan	100 Mbps / 100Mbps
20	Njësia Administrative Gur i Zi	100 Mbps / 100Mbps
21	Qendra Komunitare Gur i Zi	100 Mbps / 100Mbps
22	Njësia Administrative Postribë	100 Mbps / 100Mbps
23	Njësia Administrative Pult	100 Mbps / 100Mbps
24	Njësia Administrative Rrethina	100 Mbps / 100Mbps
25	Qendra Komunitare Shtoj	100 Mbps / 100Mbps

Adresa: Rr. 13 Dhjeton, Nr.1, Shkodër, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Konceptoi E Dardari



26	Njësia Administrative Shalë	100 Mbps / 100Mbps
27	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Theth - Sezonal)	100 Mbps / 100Mbps
28	Njësia Administrative Shosh	100 Mbps / 100Mbps
29	Njësia Administrative Velipojë	100 Mbps / 100Mbps
30	Njësia Administrative Velipojë (Plazh - Sezonal)	100 Mbps / 100Mbps
31	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Plazh - Sezonal)	100 Mbps / 100Mbps

### Linjat Backup - Shpejtësia e linjave të komunikimit

Nr	Vendndodhja	Shpejtësia (Download / Upload)
1	Bashkia Qendër	20 Mbps / 20 Mbps
2	Njësia e Prokurimit	5 Mbps / 5 Mbps
3	Rajoni Nr. 1	5 Mbps / 5 Mbps
4	Rajoni Nr. 2	5 Mbps / 5 Mbps
5	Rajoni Nr. 3	5 Mbps / 5 Mbps
6	Rajoni Nr. 4	5 Mbps / 5 Mbps
7	Rajoni Nr. 5	5 Mbps / 5 Mbps
8	Qendra Komunitare Nr. 3	5 Mbps / 5 Mbps
9	Qendra Komunitare Nr. 4	5 Mbps / 5 Mbps
10	Qendra Komunitare Nr. 5	5 Mbps / 5 Mbps
11	Qendra Komunitare Nr. 6	5 Mbps / 5 Mbps
12	Qendra Komunitare Multifunkionale	5 Mbps / 5 Mbps
13	Qendra Komunitar Rinore "Atelie"	5 Mbps / 5 Mbps
14	Qendra komunitare e Autizmit	5 Mbps / 5 Mbps
15	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint)	5 Mbps / 5 Mbps
16	Njësia Administrative Ana e Malit	5 Mbps / 5 Mbps
17	Njësia Administrative Bërdicë	5 Mbps / 5 Mbps
18	Njësia Administrative Dajç	5 Mbps / 5 Mbps
19	Qendra Komunitare Mushan	5 Mbps / 5 Mbps
20	Njësia Administrative Gur i Zi	5 Mbps / 5 Mbps
21	Qendra Komunitare Gur i Zi	5 Mbps / 5 Mbps
22	Njësia Administrative Postribë	5 Mbps / 5 Mbps
23	Njësia Adminsitrative Pult	5 Mbps / 5 Mbps
24	Njësia Adminsitrative Rrethina	5 Mbps / 5 Mbps
25	Qendra Komunitare Shtoj	5 Mbps / 5 Mbps
26	Njësia Administrative Shalë	5 Mbps / 5 Mbps

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkodër, web [www.bashkia.shkodere.gov.al](http://www.bashkia.shkodere.gov.al), e-mail: [info@bashkia.shkodere.gov.al](mailto:info@bashkia.shkodere.gov.al)

Konceptori E Dizdani



27	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Theth - Sezonal)	5 Mbps / 5 Mbps
28	Njësia Administrative Shosh	5 Mbps / 5 Mbps
29	Njësia Administrative Velipojë	5 Mbps / 5 Mbps
30	Njësia Administrative Velipojë (Plazh - Sezonal)	5 Mbps / 5 Mbps
31	Zyra e Informacionit Turistik (InfoPoint, Plazh - Sezonal)	5 Mbps / 5 Mbps

### Kërkesat teknike

Linjat e komunikimit që do të ofrohen nga Operatorët Ekonomik ofrues të këtij lloji shërbimi, janë të një rëndësi të veçantë për funksionimin dhe mbarëvajtjen e punës së Bashkisë Shkodër. Në mënyrë që të garantohet një nivel i kënaqshëm shërbimi dhe cilësor, operatori ka detyrime kontraktuale për sa i përket këtij niveli të kërkuar. Bashkia do të përcaktojë një Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (Service level Agreement) që do të jetë e bazuar në parametrat më të rëndësishëm dhe kritikë. Disa nga këto parametra të nevojshëm, por jo të vetmit, do të jenë si më poshtë vijon:

- Rrjet do të jetë i Dedikuar.
- Bashkia Qendër duhet të ketë një IP publike, statike.
- Për Bashkinë Qendër dhe për çdo Njësi të përmendur më sipër, kërkohet të që linja kryesore të jetë fibër ose radio.
- Për Bashkinë Qendër dhe për çdo Njësi të përmendur më sipër, linja Back-up mund të jetë edhe Coax, ADSL, VDSL, etj.
- Për Bashkinë Qendër dhe për çdo Njësi të përmendur më sipër, kërkohet një Encrypted VPN Router për të menaxhuar ofrimin e këtij shërbimi nga Bashkia Qendër, siç është shpjeguar në skemat e mësipërme.
- Duhet të ruhet konfigurimi i deritanishëm i IP i intranetit të Bashkisë Qendër.
- Latency (Vonesa) të jetë më e vogël se 30 ms.

Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të paraqesin një plan pune të detajuar për realizimin e shërbimit të kërkuar me detyrat, afatet kohore dhe stafin përgjegjës.

Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet që për çdo linjë, të paraqesin llojin e lidhjes (Fibër, Radio, etj) dhe pajisjet (Router, Antenë, etj) që do të përdorin. Për pajisjet, Operatori Ekonomik duhet të specifikojë Marken dhe Modelin e pajisjes.

### Disponueshmeria e shërbimit

Adresa: Rr. 13 Dhjeton, Nr.1, Shkodër, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Page 12 of 27

Konceptoi E Dizajni



Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të sigurojnë një shërbim 99.99% (jo më shumë se 4.32 minuta në muaj rënie të linjës) në çdo kohë.

#### **Round Trip Time (RTT, msec)**

Paketa nuk duhet të shfaqë një vonesë më të madhe se 110 ms bazuar në machësinë minimale të një pakete standarde prej 32 bytes.

#### **Jitter (msec)**

Jitter (burim - destinacion) = 2 ms

Jitter (destinacion - burim) = 2 ms

#### **Paketat e humbura (%):**

Numri i paketave të humbura (ne %) që nuk arrijnë në destinacion duhet të jetë më e vogël se 3.

#### **Niveli i shërbimit**

##### **✓ Instalimi i lidhjes**

1. Lidhja e shërbimit do të merret përsipër nga Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër.
2. Kjo lidhje do të jetë e dedikuar nga Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi drejt Bashkinë Shkodër (Bashkisë Qendër, Rajoneve, Njësive Administrative dhe Qendrave Komunitare) duhet të jetë me fibër optike/radio.
3. **Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të realizojë lidhjen e shërbimit në një afat kohor 2 javor nga data e nënshkrimit të kontratës.**
4. Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të sigurojë të gjithë aksesoret e nevojshëm dhe shërbimet teknike për realizimin e saj.
5. Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e kësaj lidhjeje ne rast defektesh.
6. Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e pajisjeve (Router, Antenë, etj) në rast defektesh.
7. Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër nuk mbajnë përgjegjësi për çështje te rrjetit te brendshëm te Bashkive.
8. Infrastruktura dhe asetet e lidhjes janë pronë e Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër. Në rast të ndërprerjes së kontratës operatori është i detyruar të marrë mbarsht të gjitha asetet eventuale që do të ndodhen pranë infrastrukturës se Bashkisë Shkodër (Bashkisë Qendër, Lagjeve dhe Njësive Administrative).

9. Operatori Ekonomik duhe të jetë i gatshëm të shtojë/të ndryshojë pika të reja/egzistuese ofrimi shërbimi interneti në varësi të kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Këto pika duhet të përmbushin të gjitha specifikimet teknike. Koha e instalimit të linjave të reja duhet të jetë jo më shumë se 3 (tre) ditë nga data e njoftimit të Operatorit Ekonomik.

✓ Shërbimi teknik

Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të paraqesin në ofertë termat e suportit dhe kontaktet për asistencën teknike e cila duhet të jete 24 orë 7 ne ditët e javës.

Gjithashtu :

- Koha maksimale e përgjigjes ndaj defekteve të mundshme, pra koha maksimale gjate së cilës do të kryhet përcaktimi i problemit dhe do të vendoset afati i përafërt i zgjidhjes së tij është 10 min.
- Koha maksimale e zgjidhjes së problemit, e cila nuk merr parasysh rastet e forcave madhore, nuk duhet të jetë më shumë se 150 min për Bashkinë Qendër dhe Njësitë e tjera. Disponueshmëria e shërbimit kërkohet të jetë 99.99 %. Në rast të mungesës se kësaj disponueshmerie kompania do ofrojë në mënyrë të përpjesëtuuar për çdo 1 orë mungese shërbimi, 24 orë shërbim të shtuar në periudhën kontraktuale.

Termet e suportit duhet të përfshijnë asistencë për shërbim të qëndrueshëm dhe cilësor si dhe infrastrukturën e lidhjes. Vizitat "in site" duhet të jenë të përfshira në çmim. Asistenca në vend nuk do të përfshijë kosto shtesë. Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër nuk do të përgjigjen me asistencë teknike në rast se problemet teknike do të shfaqen në infrastrukturën e brendshme të Bashkive Shkodër.

✓ *Monitorimi i shërbimit*

Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të sigurojnë monitorimin e shërbimit teknik të ofruar me anë të pajisjeve të tyre monitoruese. Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të dërgojnë një raport mujor në Bashkinë Qendër ku të paraqitet niveli i shërbimit të ofruar për secilin muaj, problemet teknike të ndryshme apo ndërprerja e shërbimit si dhe koha e zgjidhjes së problemit.

✓ *Konfidencialiteti dhe siguria e informacionit*

Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të marrë masa organizative dhe teknike për të siguruar konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që trasmetohet në linjat e komunikimit.

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Konceptori E Dizdari



Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër nuk duhet të shohin, përdorin ose bëjnë publike tek palë të treta informacionin e transmetuar në linjat e komunikimit.

**Përveç kritereve të përcaktuara me sipër Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të mundësojnë një linjë Backup emergjent për të gjitha linjat e komunikimit.**

Kjo linjë Backup duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme, por pa u limituar vetëm tek këto:

- Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të sigurojnë një linjë Backup që suporton kapacitet përkatëse të sipërpërmendura, nëpërmjet një linje të pavarur nga linja kryesore dhe që ka origjinë një pike aksesit tjetër nga linja kryesore.
- Disponueshmeria e shërbimit kërkohet të jete 99.97 %.
- Interfacing Backup Technology: Për arsye të rëndësishme të vecantë të këtyre linjave për mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e sistemeve të informacioneve të Bashkisë Shkodër bazuar në internet. Operatorët Ekonomik të interesuar për ofrimin e këtij shërbimi në Bashkinë Shkodër duhet të mundësojnë: Fault detection (All Path Fault Detection Protocoll), IP fast rerouting technology (Quickly Switch Services via the Standby Next-Hop), Fault recovery (Link Recovery after Holding).
- Typical Applications: Backup Protection towards the Trunk Interface, Backup Protection towards Weak Policy Routes. Application in the Next Generation Network Loading Network.

**Pajisja Router që do të vendoset nga operatori ekonomik në Bashkinë Qendër duhet të plotësojë minimumi këto karakteristika.**

Përshkrimi	Specifikimi
Throughput	20 Gbps
Standartet	802.3, 802.3u  IPv4 (RFC 791)  IPv6 (RFC 2460)
Portat	2 porta 10GBASE SFP+ Fiber 8 porta 1GBASE-T
Lidhja WAN	Dynamic Host Configuration Protocol (DHCP) server, DHCP client, DHCP relay agent

Adresa: Rr. 13 Dhjeton, Nr.1, Shkodër, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Page 15 of 27

Konceptoi E Dizdari



Përshkrimi	Specifikimi
	Static IP Point-to-Point Protocol over Ethernet (PPPoE) Point-to-Point Tunneling Protocol (PPTP) Transparent bridge DNS relay, Dynamic DNS (DynDNS, 3322) IPv6
Protkollet e Routimit	Static Routing Information Protocol (RIP) v1, v2, and RIP for IPv6 (RIPng)
Network Address Translation (NAT)	Port Address Translation (PAT) One-to-one NAT NAT traversal
Network edge (DMZ)	DMZ port DMZ host
Porta forwarding	Po
Porta triggering	Po
VLAN	802.1Q VLAN RV320: 7 VLANs supported RV325: 17 VLANs supported
<b>VPN</b>	
IP Security (IPsec)	IPsec site-to-site tunnels for branch office connectivity IPsec VPN tunnels via Cisco VPN client and third-party clients such as "TheGreenBow" for remote accessVPN connectivity





Përshkrimi	Specifikimi
SSL VPN	SSL VPN tunnels for remote client access
PPTP	PPTP tunnels for remote access
Enkriptimi	Data Encryption Standard (DES)  Triple Data Encryption Standard (3DES)  Advanced Encryption Standard (AES) encryption: AES-128, AES-192, AES-256
Autentifikimi	MD5/SHA1 authentication
IPsec NAT traversal	Supported for gateway-to-gateway and client-to-gateway tunnels
VPN pass-through	PPTP, Layer 2 Tunneling Protocol (L2TP), IPsec
VPN i Avancuar	Dead peer detection (DPD)  Split DNS  VPN backup  Internet Key Exchange (IKE) with certificate

#### Neni 14

##### Specifikime dhe Skicime

- 14.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi. Kontraktuesi duhet të përgatiti të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 14.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi. Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjëse përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

#### Neni 15

##### Lejet dhe Liçensat

- 15.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

#### Neni 16

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr 1, Shkoder, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Page 17 of 27

Konceptoi E Dizdari



## Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 16.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.
- 16.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 16.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 16.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

### Neni 17

#### Vendndodhja

- 17.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuar në kontratë.
- 17.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.

### Neni 18

#### Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 18.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 18.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

### Neni 19

#### Çmimi i Kontratës

- 19.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

### Neni 20

#### Afatet e Pagesës

- 20.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.



- 20.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 20.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 20.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendrike nga dita që janë kryer Shërbimet. dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 20.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

## Neni 21

### Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 21.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 21.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provoje ndonje dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

## Neni 22

### Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 22.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

## Neni 23

### Forca Madhore

- 23.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 23.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e

Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

- 23.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore. Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

#### Neni 24

##### Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 24.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 24.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 24.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 24.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Mëdhe.
- 24.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

#### Neni 25

##### Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 25.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
  - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

## Neni 26

### Negociatat dhe Amendamentet

- 26.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 26.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 26.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

## Neni 27

### Ndryshimi i Porosisë

- 27.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

## Neni 28

### Ndërprerja për Mosplotësim

- 28.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
  - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 28.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

## Neni 29

### Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 29.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

29.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

### Neni 30

#### Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- 30.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 30.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 30.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

### Neni 31

#### Nënkontrata

- 31.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë
- 31.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 31.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë te drejte të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.
- 31.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizojë një pjesë të punimeve me nënkontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kërkuar për nënkontraktuesin si dhe punimet konkrete që do të jape me nensipermarrje.
- 31.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nënkontraktorit.

### Neni 32


#### Transferimi i të Drejtave

- 32.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratësme përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

### Neni 33

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Konceptoi E Dizdari



### **Sigurimi i Kontrates**

- 33.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.
- 33.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 33.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

### **Neni 34**

#### **Baza Ligjore**

- 34.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

### **Neni 35**

#### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

- 35.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- 35.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 36**

#### **Përfaqësimi i Palëve**

- 36.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

a) Personi që do të jenë përgjegjës, administratoret e kontrates në emër të **Autoritetit Kontraktor** për ndjekjen e realizimit të shërbimit dhe përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jenë:

**z. Pavli Marku** Drejtoria e Administrimit të Sistemeve Menaxhimit të ZIN, Projekteve TIK dhe Menaxhimit të Sistemeve të Informacionit

cel/tel/fax \_\_\_\_\_

E-mail: [itadmin@bashkiashkoder.gov.al](mailto:itadmin@bashkiashkoder.gov.al)

b) Personi që do të jetë përgjegjës në emër të **Kontraktuesit** për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të jetë

**z. Marin Palushi**

cel/tel/fax 0682065605

E-mail: \_\_\_\_\_



- 36.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 36.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit
- 36.4 Administratori i Kontrates ve ne dijeni Titullarin e Autoritetit Kontraktor per çdo rast e çeshtje dhe nuk mund t'i drejtohet Kontraktuesit pa marre me pare miratimin e Titullarit te Autoritetit Kontraktor.
- 36.5 Në zbatim të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu XIII, neni 107, pika 6. "Zbatimi dhe mbikqyerja e kontratës", në përfundim të kontratës, z. **Pavli Marku** si personi që do të jenë personi përgjegjës, në emër të Autoritetit Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës do të përgatisin një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit të kontratës dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti paraqet një informacion për likudimin ose jo të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij.
- 36.6 Personi përgjegjës duhet të ndjekë me përpikëri ecurinë e zbatimit të kontratës, për t'u siguruar se zbatimi bëhet sipas termave dhe kushteve të kontratës. Personi përgjegjës, në funksion të legjislacionit të prokurimit publik ka/në këto përgjegjësi:
- harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës;
  - kryen monitorimin e zbatimit të detyrimeve të palëve në kontratë, në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
  - administron dhe verifikon dokumentacionin e dorëzuar nga kontraktori, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
  - sigurohet për kontrollin real e ligjor të kostove, cilësisë dhe afateve, kur është rasti;
  - menaxhon dhe trajton problematikat që shfaqen gjatë ekzekutimit të kontratës dhe që nuk sjellin domosdoshmërisht ndryshime/ modifikime/ përshtatje të saj;
  - dh) raporton te titullari i autoritetit/entit kontraktor për shkelje të dispozitave kontraktuale;
  - e) administron kërkesat për ndryshime/ modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës dhe sigurohet që këto kërkesa të kalojnë për miratim në strukturat përkatëse, brenda afateve të përcaktuara në kontratë;
  - ë) mban korrespondencën e përditësuar me të gjitha dokumentet e shkëmbyera me kontraktorin lidhur me zbatimin e kontratës;
  - f) përgatit informacion për çështjet e sipërcituara dhe ia përcjell personit përgjegjës për prokurimin, i cili raporton pranë APP-së

**Neni 37**  
**Lajmërimet**

Adresa Rr 13 Dhjetori, Nr.1, Shkoder, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)



Konceptori E Dredari





- 37.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 37.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

### Neni 38

#### Llogaritja e Afateve

- 38.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

### Neni 39

#### Vlefshmeria e kontratës

- 39.1 Kjo kontratë u hartua ne gjashtë kopje origjinale, pese per Autoritetin Kontraktor dhe nje per Kontraktuesin, dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palët
- 39.2 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

### KUSHTET E VEÇANTA

#### Shërbimet –Kërkesë për Propozim

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

### Neni 1

#### Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është Kontraktor Bashkia Shkoder, e përfaqësuar nga **Z. Bardh Spahia** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Shkoder që në vijim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**.
- 1.2 Kontraktori është **"ITCOM" sh.p.k** regjistruar me regjistrim fillestar me nr. CN-185667-10-08 me seli te shoqerise: Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeg, pall 164 shk 1, me nr.pasurie 4/337+1-1/2, zona kadastrale 8597-Shkoder perfaqësuar nga administratori ligjor z.Marin Palushi, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar dhe kompetencë të plotë për të përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhëniet që burojnë prej kësaj kontrate me autoritetin Kontraktor, Bashkia Shkodër për realizimin e objektit të kontratës. Në vijim do të quhet **"Kontraktuesi"**

### Neni 2

#### Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i Kontrates në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) është ofruar nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. **Nuk ka**
- 2.2 Sigurimi i Kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm: **30 ditë pas nënshkrimit të palëve të procesverbalit të marrjes në dorëzim të shërbimit.**

### Neni 3

#### Fillimi i Zbatimit

4.2 Zbatimi i kontratës duhet të filloje ne datën **01.01.2023 deri me 31.12.2023.**

### Neni 4

#### Vendndodhja e Shërbimeve

4.1 Shërbimet do të kryhen në ndërtesën e Bashkisë Shkodër, Lagjeve, Qendrave Komunitare dhe të Rajoneve sipas përcaktimeve në preventiv dhe specifikime teknik.

### Neni 5

#### Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

5.1 Perpara nenshkrimit të kontratës. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

- Personin përgjegjes për ndjekjen e shërbimit.
- Specifikimet teknike
- Grafikon e shërbimit

### Neni 6

#### Kërkesat e Raportimit

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës. Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: Në përputhje me grafikon e shërbimit.

### Neni 7

#### Siguracioni i Përgjegjesisë Profesionale

- 7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës. Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjesisë profesionale me shumë minimale si vijon: Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej: **Nuk ka**
- a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve.
  - b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve:.
  - c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve. Materialeve dhe Pajisjeve.
  - d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier:.


### Neni 8

#### Kushtet e Pagesës

6.1 Pagesa per sherbimet do te behet brenda 30 diteve nga dita e nenshkrimit nga palet te **"Procesverbalit te Marrjes ne dorezim te sherbimit"**. Siguracioni muqer i sherbimit dhe fatura perkatese e tvsh do te mbajne si date . daten e dites pasardhese te punes pas perfundimit te kryerjes se sherbimit mujor. ~~Kur dita pasardhese eshte dite pushimi ose feste zyrtare, fatura do te mbaje daten e dites se punes qe vjen pas saj.~~

Adresa Rr 13 Dhjeton, Nr.1, Shkodër, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al) e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Konceptoi E. Dizdari



6.2 Administratori i Kontrates ben miratimin e pageses vetem ne rast se eshte plotesuar dokumentacioni i meposhtem:

Faturën/at tatimore e shërbimit, lëshuar nga Kontraktuesi (1 Original)

Procesverbalin/et e marrjes në dorëzim të shërbimit (1 Original)

Situacion (1 Original)

Monedha e pageses do te jete: LEKE.

#### Neni 7

##### Pagesa Paraprake

7.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë **(nuk ka)**. Nëse nuk është specifikuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

7.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda (nuk ka) ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

7.3 Në se jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme:Nuk ka

#### Neni 8

##### Shërbimet në Lidhje me to

8.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së Shërbimeve të Lidhura

#### Neni 9

##### Zbritja e garancisë së kontratës

9.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë. Nuk parashikohet zbritje e garancise se kontrates.

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

#### PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR

##### BASHKIA SHKODËR

Kryetar i Bashkisë

Bardh SPANJA



#### PER OPERATORIN EKONOMIK

"ITCOM" sh.p.k

Përfaqësuar nga administratori ligjor

Marin PALUSHI



Adresa: Rr. 13 Dhjeton, Nr.1, Shkodër, web [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

Page 27 of 27

Konceptoi: E. Dizdari



